VENDIM
Nr. 56, datë 6.8.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR VEPRIMET ME FONDET NË VLERA MONETARE NË BANKËN E SHQIPËRISË"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a", të nenit 43, shkronja "c" dhe të kreut V të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për veprimet me fondet në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Emisionit në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, udhëzimi "Për përpunimin e monedhave shqiptare" miratuar me vendimin nr. 68, datë 19.7.2000, të Këshillit Mbikëqyrës, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR VEPRIMET ME FONDET NË VLERA MONETARE NË BANKËN E SHQIPËRISË

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe rregullave për veprimet me fonde në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a", nenit 43, shkronja "c" dhe kreut V, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet "ligji për bankat".

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, si dhe klientët e tjerë me status të veçantë që kryejnë veprime me fonde në vlera monetare me Bankën e Shqipërisë, si dhe Banka e Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) "përpunim i kartëmonedhave" – është kontrolli i sasisë, autenticitetit dhe përshtatshmërisë për qarkullimin e kartëmonedhave, kryer nga subjektet e kësaj rregulloreje me anë të makinave të trajtimit të kartëmonedhave ose manualisht nga një anëtar i trajnuar i stafit;

b) "përpunim i automatizuar i kartëmonedhave" – është përpunimi i kartëmonedhave me anë të makinerive të trajtimit të kartëmonedhave;

c) "përpunimi manual i kartëmonedhave" – është vlerësimi vizual dhe me prekje manuale i përshtatshmërisë së kartëmonedhave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare";

d) "kontrolli për përshtatshmëri i kartëmo-nedhave" – është ekzaminimi i kartëmonedhave, me qëllim veçimin e kartëmo-nedhave të përshtatshme për qarkullim nga ato të papërshtatshme, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe kriteret e riciklimit të kartëmonedhave shqiptare";

e) "klientë me status të veçantë" – janë personat të cilët kanë fituar statusin e klientit të Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet një ligji ose marrëveshjeje të veçantë dhe mund të kryejnë veprime me fonde në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë;

f) "qendra cash-i" – janë strukturat organizative dhe mjediset e Bankës së Shqipërisë në të cilat kryhen veprime me fonde në vlera monetare, të tilla si Departamenti i Emisionit dhe degët e Bankës së Shqipërisë;

g) "maceta" – është paketimi i përbërë nga 100 copë kartëmonedhash të së njëjtës prerje, të vendosura nga e njëjta anë (kokë me kokë) dhe të lidhura me fashetë letre të vendosur kryq në të dyja anët e macetës. Fasheta e letrës është e firmosur nga punonjësit përgjegjës që kanë kryer paketimin e saj dhe përmban vulën e bankës;

h) "fishekë-rulon" – është paketimi i përbërë nga 25 copë ose 50 copë monedhash metalike;

i) "pako" – është paketimi i një sasie prej 10 copë macetash për kartëmonedhat ose 10/20 fishekë-rulonë për monedhat metalike;

j) "koli" – është ambalazhi i mbyllur me shirit të numërtuar ose i plumbosur me vulë të dallueshme i tillë si arka, thasë, kuti, qese, ku vendosen kartëmonedha ose monedha metalike. Në rastin e arkave të ardhura nga prodhimi, mbyllja është realizuar me dy shirita plastikë të vendosur paralel/kryq me njëra-tjetrën;

k) "dërgesë" – është tërësia e kolive me vlera monetare për një depozitim apo tërheqje;

l) "fletëdërgesë" – është dokumenti i transportit që shoqëron vlerat monetare në të cilin përcaktohet numri i kolive, sasia dhe vlera e fondeve, e detajuar sipas prerjeve;

m) "vlera monetare" – janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare dhe sipas rastit bonot e privatizimit, që përdoren ose janë përdorur më parë si mjet pagese sipas përcaktimeve ligjore;

n) "çek" – është dokumenti që plotësohet nga banka tregtare dhe shërben për tërheqjen e fondeve nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren "Për kushtet e veçanta të punës në Bankën e Shqipërisë;

o) "BSH"- është Banka e Shqipërisë.

KREU II
KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR VEPRIMET ME FONDE NË VLERA MONETARE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Neni 5
Veprimet me fonde në vlera monetare

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, kryejnë veprime me fonde në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë si më poshtë:

a) për ushtrimin normal të veprimtarisë, sipas kërkesës së tyre, kryejnë veprime për depozitimin ose tërheqjen e kartëmonedhave dhe monedhave shqiptare;

b) me kërkesë të tyre kryejnë depozitimin e bonove të privatizimit që janë përdorur më parë si mjet pagese sipas përcaktimeve ligjore.

2. Veprimet me fonde në vlera monetare kryhen në Departamentin e Emisionit dhe në degët e Bankës së Shqipërisë në ditët e punës gjatë orarit 08:30–14:30.

Neni 6

Nënshkrimet e autorizuara

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, në fillim të çdo viti dërgojnë pranë Bankës së Shqipërisë nënshkrimet e personave të autorizuar për të vepruar në emër të tyre.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje njoftojnë me shkrim Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në nënshkrimet e dërguara, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 7

Lista e personave të autorizuar për të kryer fizikisht në qendrat e cash-it veprime me fonde në vlera monetare

1. Subjektet e kësaj rregulloreje në fillim të çdo viti dërgojnë pranë Departamentit të Emisionit në Bankën e Shqipërisë dhe në Degët e Bankës së Shqipërisë listën e personave të autorizuar për të kryer fizikisht tërheqje apo depozitime me fonde në vlera monetare, pranë qendrave të cash-it.

2. Subjektet e kësaj rregulloreje njoftojnë me shkrim Bankën e Shqipërisë për çdo ndryshim në listën e dërguar, sipas pikës 1 të këtij neni.

KREU III

VEPRIMET PËR DEPOZITIMET E FONDEVE NË VLERA MONETARE

Neni 8

Depozitimi i fondeve

1. Subjektet, si rregull mund të depozitojnë fonde në vlera monetare në qendrat e cash-it, në Bankën e Shqipërisë vetëm një herë në ditë. Depozitimi më shumë se një herë në ditë kryhet me miratimin paraprak të drejtuesit të njësisë së qendrës së cash-it, në raste të veçanta dhe të argumentuara me nevoja të paparashikuara ose të lidhura me largësi gjeografike nga degë të caktuara.

2. Shuma minimale e fondeve që mund të kërkohet për depozitim duhet të plotësojë karakteristikat e mëposhtme:

a) numri i kartëmonedhave në çdo dërgesë për çdo prerje të plotpjesëtohet me 1000. Në rastin e depozitimeve në Degët e Bankës së Shqipërisë, numri i kartëmonedhave mund të plotpjesëtohet me 100;

b) numri i monedhave metalike për çdo prerje të plotpjesëtohet me 500.

3. Depozitimi i fondeve në kujdestari përjashtohet nga kufizimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 9

Kategoritë e dërgesave për depozitim fondesh në BSH

1. Subjektet që do të depozitojnë fonde në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë përgatisin dërgesa të veçanta për fondet e klasifikuara si më poshtë:

a) dërgesat me kartëmonedha të përshtatshme për qarkullim;

Në këtë kategori përfshihen dërgesat me kartëmonedha për të cilat, sipas përcaktimeve në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe riciklimin e kartëmonedhave shqiptare", subjekti ka kryer përpunim të automatizuar ose manual të kartëmonedhave dhe në përfundim të procesit të përpunimit, kartëmonedhat kanë rezultuar të përshtatshme për qarkullim;

b) dërgesat me kartëmonedha të papërshtat-shme për qarkullim;

Në këtë kategori përfshihen dërgesat me kartëmonedha për të cilat, sipas përcaktimeve në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe riciklimin e kartëmonedhave shqiptare", subjekti ka kryer përpunim të automatizuar ose manual të kartëmonedhave dhe në përfundim të procesit të përpunimit kanë rezultuar të papërshtatshme për qarkullim.

c) dërgesat me monedha metalike;

d) dërgesat me bono privatizimi.

2. Subjektet plotësojnë fletëdërgesë të veçantë për secilën nga kategoritë e dërgesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 10

Përgatitja e fondeve për depozitim në BSH

1. Subjektet, sipas fletëdërgesave të plotësuara, përgatisin fondet për depozitim në BSH, si më poshtë:

a) dërgesat me kartëmonedha:

i) Kartëmonedhat paketohen sipas prerjeve në pako me nga 10 maceta ose në maceta në rastin kur numri i macetave – për depozitimet në Degë - nuk është i mjaftueshëm për të formuar një pako. Pakot janë të paketuara në qese plastmasa të mbyllura në vakuum ose të lidhura kryq me shirit plastik. Në mungesë të paketimit me vakuum apo me shirit plastik, pakot mund të lidhen kryq me spango duke u kujdesur që të mos dëmtohen kartëmonedhat e paketuara.

ii) Pakot dhe/ose macetat me kartëmonedhat paketohen sipas prerjeve në koli me përbërje 10 ose 20 pako. Në rastin kur numri i pakove të kërkuara nuk është i mjaftueshëm për të formuar koli të plota (10 ose 20 pako), kolia e fundit formohet me numrin e pakove dhe të macetave të mbetura pas paketimit të kolive të plota.

iii) Kolitë mbyllen duke iu vendosur një etiketë, ku janë shënuar prerja dhe sasitë e kartëmonedhave, që janë vendosur brenda në koli, shenja e mbylljes, si edhe data kur mbyllet kolia. Në rastin kur kolia përbëhet nga kuti plastike, mbyllja bëhet në katër vende dhe etiketa vendoset në njërën prej mbylljeve. Etiketa nënshkruhet nga punonjësit që kanë kryer mbylljen e kolisë.

b) dërgesat me monedha metalike:

i) Monedhat metalike, paketohen sipas prerjeve në fishekë-rulon letre, sipas tabelës së mëposhtme:

Prerja	Sasia (copë)	Vlera (lekë)
100 lekë	25/50	2500/5000
50 lekë	25/50	1250/2500
20 lekë	25/50	500/1000
10 lekë	50	500
5 lekë	50	250
1 lekë	50	50

ii) fishekët-rulonë paketohen sipas prerjeve në koli me përbërje 500/1000 monedha metalike;

iii) kolitë me prerje mbyllen duke iu vendosur një etiketë, ku të jenë shënuar prerja dhe sasitë e monedhave, të cilat janë të vendosura brenda në koli, shenja e mbylljes, si edhe data kur mbyllet kolia. Etiketa duhet të jetë e nënshkruar nga punonjësit që kanë kryer mbylljen e kolisë.

c) Dërgesat me bono privatizimi paketohen në koli, mbyllen duke iu shënuar një etiketë ku të jenë shënuar prerja dhe sasitë e vendosura brenda në koli, shenja e mbylljes, si edhe data kur mbyllet kolia. Etiketa nënshkruhet nga punonjësit që kanë kryer mbylljen e kolisë.

2. Në rastin kur paketimi i monedhave metalike në fishekë-rulonë nuk është i mundur, subjektet kryejnë paketimin e tyre në koli me nga 500 copë ose 1000 copë monedha metalike, duke zbatuar rregullat e përcaktuara për mbylljen e kolisë.

Neni 11

Veprimet për depozitimin e fondeve në sportel

1. Depozitimi i fondeve nga subjektet kryhet në mjediset e qendrave të cash-it nga personat e autorizuar nga vetë subjekti.

2. Për pranimin e fondeve në sportel, punonjësi i Bankës së Shqipërisë kryen veprimet e mëposhtme:

a) përcakton identitetin e personit të autorizuar për depozitimin e fondeve në vlera monetare në emër të subjektit. Përcaktimi i identitetit do të kryhet duke krahasuar personin e paraqitur në sportel me dokumentet personale të personit të autorizuar për depozitimin e parave të gatshme në emër të bankës dhe më pas duke krahasuar përmbajtjen e të dhënave të dokumentit të identifikimit me të dhënat mbi personin e autorizuar për depozitimin e fondeve në emër të bankës, të specifikuara në listën e personave të autorizuar që Banka ka paraqitur paraprakisht;

b) kontrollon dërgesën me fonde sipas fletëdërgesës së paraqitur, duke numëruar kolitë dhe duke kontrolluar shenjat e mbylljes;

c) pranon fondet duke firmosur fletëdërgesën e përcaktuar në aneksin 1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje dhe librin e shoqëruesit të fondeve.

3. Në rastin kur fondet paraqiten me diferenca në numër kolish ose me parregullsi në mbylljen e tyre, fondet pranohen, por ndërmjet punonjësve të Bankës së Shqipërisë dhe personit të autorizuar për

depozitimin e fondeve mbahet një procesverbal sipas aneksit 2, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, në të cilin evidentohen të gjitha konstatimet në dërgesën e mbërritur. Në rastin kur kolia paraqet parregullsi në mbyllje, punonjësit e Bankës së Shqipërisë kryejnë hapjen e kolisë dhe kontrollin e fondeve të depozituara në prani të personit të autorizuar për depozitimin e tyre në emër të subjektit. Kontrolli i fondeve kryhet sipas përcaktimeve në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

4. Për dërgesat me kartëmonedha dhe monedha metalike, menjëherë me pranimin e fondeve, kryhet dhe veprimi i kreditimit të llogarisë përkatëse të subjektit.

Neni 12

Kontrolli i fondeve të depozituara

1. Kontrolli i fondeve të depozituara në Bankën e Shqipërisë kryhet nga tre punonjës me përgjegjësi të barabartë duke zbatuar procedurat e mëposhtme:

a) kontrolli i fondeve kryhet për çdo dërgesë më vete, duke zbatuar radhën e mbërritjes së dërgesave. Si rregull, kontrolli kryhet në datën e mbërritjes (pranimit) të dërgesës, por jo më vonë se dita pasardhëse e punës;

b) për dërgesat me kartëmonedha, sistemohen kolitë sipas prerjeve dhe bëhet hapja e tyre nga tre punonjësit përgjegjës;

c) punonjësit kryejnë kontrollin e fondeve duke numëruar sasinë e pakove të kartëmonedhave për secilën prerje. Pas verifikimit të sasisë së pakove për çdo prerje, punonjësit kryejnë numërimin e macetave, duke u siguruar për sasinë e 10 (dhjetë) macetave në çdo pako, si dhe sasinë totale të macetave për çdo prerje;

d) fondet e kontrolluara, kur rezultojnë pa diferenca, sistemohen në prerje dhe shoqërohen me kartelën përkatëse;

e) kontrolli i fondeve për monedhat metalike dhe bonot e privatizimit kryhet vetëm për numrin e kolive.

2. Në rastin kur nga kontrolli i fondeve të një dërgese rezultojnë diferenca, kryhen veprimet e mëposhtme:

a) punonjësit që kanë kryer kontrollin e fondeve mbajnë procesverbalin sipas aneksit 3, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

b) për diferencat, në sasi dhe në vlerë sipas prerjeve, të rezultuara nga kontrolli i kartëmonedhave dhe monedhave metalike, njoftohet subjekti duke i dërguar një kopje të procesverbalit të mbajtur dhe bëhet regjistrimi kontabël, duke kontabilizuar diferencat në llogarinë rrjedhëse të subjektit.

Neni 13

Përpunimi i fondeve të depozituara

1. Fondet e kontrolluara sipas nenit 12 të kësaj rregulloreje, përpunohen duke zbatuar procedurat e mëposhtme:

a) përpunimi i fondeve kryhet për çdo dërgesë më vete. Si rregull, fondet përpunohen ditën pasardhëse të pranimit të dërgesës, por jo më vonë se 10 ditë pune nga pranimi i fondeve;

b) përpunimi i kartëmonedhave kryhet sipas përcaktimeve në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe riciklimin e kartëmonedhave shqiptare" dhe konsiston në:

i) kontrollin e sasisë së kartëmonedhave për çdo prerje dhe veçimin e kartëmonedhave të përshtatshme për qarkullim nga ato të papërshtatshme për qarkullim;

ii) veçimin e kartëmonedhave të dyshuara si të falsifikuara;

c) përpunimi i monedhave metalike kryhet me makina të përpunimit të monedhave dhe konsiston në:

i) kontrollin e sasisë së monedhave metalike për çdo prerje dhe veçimin e monedhave të përshtatshme për qarkullim nga ato të papërshtatshme për qarkullim;

ii) veçimin e monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara;

d) përpunimi i bonove të privatizimit kryhet manualisht për përcaktimin autenticitetit, sasisë dhe vlerës së tyre.

2. Në rastin kur nga përpunimi i fondeve të një dërgese rezultojnë diferenca, kryhen veprimet e mëposhtme:

a) punonjësit që kanë kryer përpunimin mbajnë procesverbalin sipas aneksit 4, bashkë-ngjitur kësaj rregulloreje;

b) për diferencat, në prerje e në vlerë të rezultuara nga përpunimi i kartëmonedhave dhe monedhave

metalike, njoftohet subjekti duke i dërguar një kopje të procesverbalit të mbajtur dhe bëhet regjistrimi kontabël, duke kontabilizuar diferencat në llogarinë rrjedhëse të subjektit.

3. Në rastin kur nga përpunimi i fondeve rezultojnë kartëmonedha ose monedha metalike të dyshuara si të falsifikuara apo të pavlefshme, përveç veprimeve të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, kartëmonedhat ose monedhat metalike dërgohen pranë zyrës së qendrës kombëtare të analizës për trajtimin e mëtejshëm të tyre.

KREU IV
VEPRIMET PËR TËRHEQJET NË VLERA MONETARE

Neni 14
Kërkesa për tërheqjet në vlera monetare

1. Subjektet mund të tërheqin fonde në vlera monetare në Bankën e Shqipërisë vetëm një herë në ditë në një qendër cash-i.

2. Subjektet që kërkojnë të bëjnë tërheqje fondesh në vlera monetare janë të detyruar të dërgojnë në Bankën e Shqipërisë një ditë përpara në formë elektronike kërkesën përkatëse, e cila duhet të përmbajë sasinë dhe vlerën totale të fondeve që kërkohen, të detajuar sipas prerjeve.

3. Në ditën e kryerjes së tërheqjes së fondeve, subjekti paraqet dokumentacionin përkatës, kërkesën dhe çekun, të plotësuar, nënshkruar dhe vulosur nga personeli i autorizuar i subjektit.

4. Shuma minimale e fondeve që mund të kërkohet për t'u tërhequr duhet të plotësojë karakteristikat e mëposhtme:

a) numri i kartëmonedhave për çdo prerje të plotpjesëtohet me 1000. Në rastin e kërkesave të paraqitura në Degët e Bankës së Shqipërisë, si dhe kur kërkohen kartëmonedha prerja 5000 lekë, numri i kartëmonedhave të kërkuara mund të plotpjesëtohet me 100;

b) numri i monedhave metalike, për çdo prerje, të plotpjesëtohet me 5000. Në degët e Bankës së Shqipërisë numri i monedhave që kërkohet të tërhiqen, për çdo prerje, mund të plotpjesëtohet me 1000.

5. Përjashtimisht nga përcaktimet e pikës 1 dhe 4 të këtij neni, në raste të veçanta dhe të argumentuara me nevoja të paparashikuara, tërheqjet bëhen me miratimin paraprak të drejtuesit të njësisë së qendrës së cash-it, bazuar në kërkesën e subjektit, të paraqitur në formë elektronike.

Neni 15
Përgatitja e dërgesave me fonde në Bankën e Shqipërisë

1. Me marrjen e kërkesës nga subjekti, qendrat e cash-it fillojnë procedurat e brendshme për miratimin e saj, duke kryer veprimet e mëposhtme:

a) përcaktojnë rregullshmërinë e çekut, duke kontrolluar firmat e autorizuara për të nënshkruar;

b) kontrollojnë identitetin e personit të përcaktuar për tërheqjen e fondeve, duke u kujdesur që të jetë në listën e personave të autorizuar nga subjekti për të kryer veprime me vlera monetare;

c) përcaktojnë sasinë dhe vlerën totale të fondeve, të detajuar sipas prerjeve. Si rregull, detajimi me prerje është i njëjtë me kërkesën e paraqitur, por rast pas rasti, bazuar mbi analizat e brendshme për sasinë e prerjeve në qarkullim, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kryejë zëvendësime prerjesh brenda shumës totale të kërkuar, duke informuar dhe subjektin për këtë qëllim.

2. Me miratimin e kërkesës, punonjësit përgjegjës për përgatitjen e dërgesës me fonde plotësojnë fletëdërgesën, me prerje e në vlerë, sipas aneksit 5 bashkëngjitur kësaj rregulloreje dhe përgatisin fondet për dërgesë si më poshtë:

a) dërgesat me kartëmonedha përgatiten dhe paketohen sipas përcaktimeve në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 10, të kësaj rregulloreje;

b) dërgesa me monedhat metalike:

i) monedhat metalike, paketohen sipas prerjeve në fishekë-rulonë letre me përbërje prej 25 ose 50 monedhash metalike, sipas përcaktimeve në nenin 10 të kësaj rregulloreje. Fishekzjarrët-rulonë paketohen në pako kartoni me nga 500 monedha metalike. Pakoja e kartonit është e vulosur dhe e firmosur nga punonjësit që kryejnë mbylljen e saj. Monedhat metalike 50 lekë dhe 100 lekë, që hidhen për herë të parë në qarkullim, janë të paketuara në pako kartoni përkatësisht me nga 1200 copë dhe 1000 copë monedha metalike;

ii) pakot me monedhat metalike paketohen sipas prerjeve në koli (thes bezeje) me përbërje prej të paktën 1000 copë monedhash metalike;

iii) kolitë me prerje mbyllen duke iu vendosur një etiketë, ku janë shënuar prerja dhe sasitë e monedhave të cilat janë të vendosura brenda në koli, shenja e mbylljes, si edhe data kur mbyllet kolia. Etiketa nënshkruhet nga punonjësit që kanë kryer mbylljen e kolisë.

Plotësohet fletëdërgesë e veçantë për kartëmonedhat dhe fletëdërgesë e veçantë për monedhat metalike.

3. Banka e Shqipërisë furnizon subjektet vetëm me kartëmonedha të përpunuara sipas përcaktimeve në rregulloren "Për kontrollin për autenticitet dhe përshtatshmëri dhe riciklimin e kartëmonedhave shqiptare", plotësojnë kriteret për qarkullim, si dhe me monedha metalike të përpunuara të përshtatshme për qarkullim.

Neni 16

Veprimet për tërheqjen e fondeve në sportel

1. Tërheqja e fondeve nga subjektet kryhet në mjediset e qendrave të cash-it nga personat e autorizuar nga vetë subjekti.

2. Para dorëzimit të fondeve, punonjësi/t i/e qendrës së cash-it të ngarkuar me dorëzimin e vlerave kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) përcaktojnë identitetin e personit të autorizuar për tërheqjen e vlerave monetare në emër të subjektit. Përcaktimi i identitetit do të kryhet duke kontrolluar dhe krahasuar dokumentet personale të personit të autorizuar për tërheqjen e parave të gatshme në emër të bankës me të dhënat e specifikuara në kërkesën për tërheqjen e fondeve dhe çekun që banka ka paraqitur;

b) për çdo fletëdërgesë, kontrollon fondet duke numëruar kolitë sipas prerjeve dhe ia dorëzon ato personit të autorizuar për tërheqjen e tyre, së bashku me një kopje të fletëdërgesës të firmosur dhe të vulosur.

3. Personi i autorizuar për tërheqjen e fondeve në emër të subjektit kryen veprimet e mëposhtme:

a) kontrollon dërgesën me fonde duke numëruar kolitë dhe duke kontrolluar shenjat e mbylljes;

b) pranon fondet duke firmosur fletëdërgesën dhe librin e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të fondeve.

4. Menjëherë me pranimin e fondeve nga subjekti kryhet dhe veprimi i debitimit të llogarisë përkatëse të subjektit.

5. Banka e Shqipërisë nuk pranon reklamime nga subjektet për diferenca në lidhje me dërgesat e fondeve, sipas përcaktimeve në nenet 15 dhe 16 të kësaj rregulloreje, por ajo do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për sqarimin e procedurës së kryer gjatë përgatitjes së dërgesës për të cilën pretendohet diferenca.

6. Në rastin kur fondet janë dërguar në kuti plastike të riciklueshme dhe të prodhuara nga BSH-ja, subjekti është i detyruar të kthejë mbrapsht kutitë brenda një afati prej 10 ditësh pune nga data e marrjes së tyre në dorëzim.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Dispozitë kalimtare

Subjektet e kësaj rregulloreje janë të detyruara të plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, si dhe të përshtatin kuadrin e brendshëm rregullativ sipas përcaktimeve të saj, jo më vonë se 3 muaj pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 18

Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit nga subjektet të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse në përputhje me ligjin për bankat dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 19
Dispozitë e fundit

Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI
Gent Sejko

ANEKS 1
FORMATI I FLETËDËRGESËS NË SUBJEKT

BANKA .....

_____

FLETËDËRGESË VLERASH MONETARE

Nr._____, datë__.__.201_

Për: Bankën e Shqipërisë
Lloji i monedhës _____

PËRMBAJTJA E DËRGESËS		**VLERA**
sasia (copë)	**prerjet**	
Nr. i kolive gjithsej (.....) (.....)	Vlera me shifra: _____ Vlera me fjalë: (_____ _____	

Numrat unik të fashetave të sigurisë:

_____

_____

Personat përgjegjës formues të kolive: _____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

I ngarkuar me dorëzimin e dërgesës vetëm si numër kolish:

Mora në dorëzim _____(_____ ___) Koli

Sasia e kolive me fjalë

_____

(emër, mbiemër, firmë)

PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Mora në dorëzim:.....(.....) Koli

_____

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKS 2

PROCESVERBAL PËR KONTROLLIN E KOLIVE NR._____

Mbajtur sot më datë __.__.20__ në ..... mbi kontrollin e kolive të ardhura me dërgesën nr. __, datë __.__.20__, nga Banka _____.

Nga kontrolli i ushtruar duke numëruar një për një gjendjen e kolive të ardhura, sipas dërgesës së mësipërme, rezultuan këto defekte/mangësi:

_____

_____

_____

_____

_____

Ky procesverbal mbahet në 2 kopje, nga të cilat një i jepet shoqëruesit të fondeve dhe një mbahet

nga zyra e arkës për veprim.

Punonjësit përgjegjës për kontrollin e kolive që kanë konstatuar defektet/mangësitë:

_____ (emër, mbiemër, firmë)

_____ (emër, mbiemër, firmë)

_____ (emër, mbiemër, firmë)

ANEKS 3
PROCESVERBAL DIFERENCASH NR._____

Mbajtur sot më datë __.__.20__, në ..... mbi kontrollin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të ardhura me dërgesën nr. __, datë __.__.20__, nga Banka _____.

Nga kontrolli i ushtruar duke numëruar një për një gjendjen e macetave me kartëmonedhave dhe kolive të monedhave, sipas dërgesës së mësipërme, rezultuan këto diferenca:

MUNGESË

Diferenca me pak

Prerja	Sasia copë	Vlera lekë
5000		
.....		
TOTALI		

TEPRICË

Diferenca me tepër		
Prerja	**Sasia copë**	**Vlera lekë**
5000		
.....		
TOTALI		

Ky procesverbal mbahet në 3 kopje, nga të cilat dy i jepen kontabilitetit e Bankës së Shqipërisë dhe një mbahet nga zyra e arkës për veprim.

Punonjësit përgjegjës për kontrollin e fondeve që kanë konstatuar diferencat:

_____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKS 4
PROCESVERBAL DIFERENCASH NR._____

Mbajtur sot më datë __.__.20__ në Zyrën e Përpunimit të fondeve të Bankës së Shqipërisë mbi përpunimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të ardhura me dërgesën nr. __, datë __.__.20__, nga Banka _____.

Nga kontrolli i ushtruar nëpërmjet numërimit një për një të gjendjes së kartëmonedhave dhe monedhave në dërgesën e mësipërme, rezultuan këto diferenca:

MUNGESË

Diferenca me pak			**Lloji i diferencës më pak në sasi (copë)**			
Prerja	**Sasia copë**	**Vlera lekë**	**Më pak**	**Të falsifikuara**	**Të pavlefshme (të dëmtuara qëllimisht)**	
5000						
.....						
Totali						

TEPRICË

Diferenca me tepër			**Lloji i diferencës me tepër në sasi (copë)**			
Prerja	**Sasia copë**	**Vlera lekë ***	**Më pak**	**Të falsifikuara**	**Të pavlefshme (të dëmtuara qëllimisht)**	
5000						
.....						
TOTALI						

*Në tabelën "tepricë", kolona "vlera në lekë" nuk plotësohet për kartëmonedhat dhe monedhat metalike të falsifikuara apo të pavlefshme. Kjo kolonë i korrespondon vetëm kartëmonedhave apo monedhave metalike të rregullta.

Bashkëlidhur procesverbalit janë fashetat e macetave të kartëmonedhave apo mbështjelljet apo etiketat e monedhave metalike në të cilat janë vërtetuar diferencat.

Kartëmonedhat dhe monedhat metalike të dyshuara si të falsifikuara përcillen në Zyrën e Qendrës Kombëtare të Analizës për verifikim të mëtejshëm.

Ky procesverbal mbahet në 3 kopje, nga të cilat dy i jepen kontabilitetit e Bankës së Shqipërisë dhe një mbahet nga Zyra e Përpunimit të Fondeve.

Punonjësit përgjegjës për përpunimin e fondeve që kanë konstatuar diferencat:

_____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

_____

(emër, mbiemër, firmë)

ANEKS 5
FORMATI I FLETËDËRGESËS NË BANKËN E SHQIPËRISË

BANKA E SHQIPËRISË

_____

FLETËDËRGESË VLERASH MONETARE
Nr.____, data__.__.201_

Për kryerjen e pagesës sipas çekut _____ nr._____, datë_____

Për: Bankën .....
Lloji i monedhës _____

PËRMBAJTJA E DËRGESËS		**VLERA**
Sasia (copë)	**Prerjet**	
Nr. i kolive gjithsej (.....) (.....)	Vlera me shifra: _____ Vlera me fjalë: (_____ _____)	

Numri i thasëve ____
Numri i arkave ____
Numri i _____ ____

Numrat unik të _____:

..... _____ ..... _____ _____
..... _____ ..... _____ _____
..... _____ ..... _____ _____
..... _____ ..... _____ _____
..... _____ ..... _____ _____
.... _____ _____

Të ngarkuarit me vlera: _____

(emër,
mbiemër, firmë)

_____

(emër,
mbiemër, firmë)

_____

(emër,
mbiemër, firmë)

I ngarkuar me marrjen në dorëzim të dërgesës:

Mora në dorëzim _____(_____ ___) Koli
Sasia e kolive me fjalë

_____

(emër, mbiemër, firmë)